

Vendim nr. 74 datë 12.04.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Sonila Bejtja,	Anëtare
Fiona Papajorgji,	Anëtare

në datën 12.04.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 3 (N) 2023 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **NAIM RRAFMANI**

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2022-1832 (275), datë 14.07.2022 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 43, 131, pika 1, shkronja “F”, dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 6, pika 1 dhe 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fiona Papajorgji, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkesuesi në vitin 1992, pa leje të organeve kompetente, ka ndërtuar një shtëpi banimi me sipërfaqe 64 m², në një truall me sipërfaqe 160 m². Me miratimin e ligjit nr. 9304,

datë 23.10.2014 “Për legalizimin dhe urbanizimin e banesave informale”, të ndryshuar, kërkuesi ka depozituar në njësinë bashkiake nr. 1, Tiranë, aktin e vetëdeklarimit nr. 902, datë 23.03.2005. Me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 125, datë 17.02.2010 “Për miratimin e kalimit të pronësisë së disa parcelave ndërtimore në favor të poseduesve të objekteve informale”, kërkuesit i është miratuar kalimi i parcelës së ndërtimit, sipas aktit të vetëdeklarimit të tij në ish-Agjencinë e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritetit të Zonave dhe Ndërtimeve Informale (ALUIZNI), Tiranë.

2. Me shkresën nr. 3296 prot., datë 31.08.2017 të Drejtorisë së ish-ALUIZNI-t, Tirana Jug, kërkuesi është njoftuar për vendimin nr. 2822, datë 31.08.2017 (*vendimi nr. 2822/2017*), nëpërmjet të cilit është vlerësuar se ndërtimi informal i sipërcituar, i vetëdeklaruar nga ai, nuk i plotëson kriteret kualifikuese dhe, për pasojë, është vendosur përjashtimi i objektit nga procesi i legalizimit. Sipas dëftesës së komunikimit, rezulton se paditësi ka marrë dijeni për vendimin në datën 05.09.2017. Kundër këtij vendimi kërkuesi nuk ka paraqitur ankim administrativ.

3. Me shkresën nr. 3296/1 prot., datë 08.09.2017, kërkuesit i është komunikuar urdhri nr. 95, datë 08.09.2017 “Për përjashtimin nga procesi i legalizimit të objektit të vetëdeklaruar me nr. 902 prot., datë 23.03.2005 në emër të z. Naim Rrafmani”.

4. Në datën 14.09.2017, në objektin e sipërcituar është ushtruar kontroll nga inspektorët e Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit (IKMT), të cilët në përfundim kanë mbajtur procesverbalin e konstatimit të kundërvajtjes nr. 05, datë 14.09.2017 ku, ndër të tjera, thuhet: “*Ndërtim pa leje objekt I-katësh*”. Mbi bazën e këtij procesverbali, IKMT-ja ka nxjerrë aktet administrative, vendimet nr. 10, datë 15.09.2017 “Për dënim me gjobë” (*vendimi nr. 10/2017*), sipas të cilit për kundërvajtjen administrative të konsumuar kërkuesi dënohej me gjobë në vlerën 500.000 lekë, dhe nr. 16, datë 15.09.2017 “Për prishjen e objektit të kundërligjshëm” (*vendimi nr. 16/2017*). Ky i fundit është ekzekutuar nga IKMT-ja në datën 15.09.2017 dhe i është njoftuar kërkuesit me shkresën nr. 449/2 prot., datë 19.09.2017.

5. Në këto kushte, kërkuesi, duke mos qenë dakord me vendimet e sipërcituara, i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë në datën 12.10.2017, me kërkesëpadi me objekt paligjshmërinë e akteve administrative, përkatësisht vendimeve nr. 2822/2017 të ALUIZNI-t Tirana Jug, nr. 10/2017 dhe nr. 16/2017 të IKMT-së, si dhe detyrimin e palëve të paditura për shlyerjen e vlerës së pronës dhe dëmin e shkaktuar.

6. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 861, datë 09.03.2018, ka vendosur: “Pranimin e kërkesëpadisë së paraqitur nga kërkuesi. Shfuqizimin e aktit administrativ, vendimin nr. 2822/2017 të Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t, Tirana Jug.

Shfuqizimin e akteve administrative, vendimeve nr. 16/2017 dhe nr. 10/2017 të IKMT-së. Detyrimin e palëve të paditura, IKMT-në dhe Drejtorinë Rajonale të ALUIZNI-t, Tirana Jug, që të dëmshpërblejnë në mënyrë solidare kërkuesin në shumën 6.973.200 (gjashtë milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e dyqind) lekë [...].” Kundër këtij vendimi kanë bërë ankim Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë (ish-Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t, Tirana Jug), IKMT-ja dhe Avokatura e Shtetit.

7. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 258 (86-2019-286), datë 01.02.2019, ka vendosur: “Ndryshimin e vendimit nr. 861, datë 09.03.2018 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Pranimin e pjesshëm të padisë. Shfuqizimin e pjesshëm të aktit administrativ vendimit nr. 2822/2017, të Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t, Tirana Jug, vetëm për sipërfaqen prej 80.8 m² si akt në kundërshtim me ligjin. Shfuqizimin e pjesshëm të akteve administrative, vendimeve nr. 16/2017 dhe nr. 10/2017, të IKMT-së, për sipërfaqen e objektit prej 80.8 m², si akte në kundërshtim me ligjin. Detyrimin e palëve të paditura, që të dëmshpërblejnë në mënyrë solidare kërkuesin në shumën 6. 302.400 (gjashtë milion e treqind e dymijë e katërqind) lekë [...].” Kundër këtij vendimi kanë bërë rekurs Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë (ish Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Tirana Jug), IKMT-ja dhe Avokatura e Shtetit.

8. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë (*Gjykata e Lartë*), me vendimin nr. 234, datë 23.04.2019, ka vendosur pezullimin e ekzekutimit të vendimeve të gjykatave më të ulëta, ndërsa, me vendimin nr. 234/1, datë 28.0.2021, ka vendosur pranimin e kërkesës së paraqitur nga kërkuesi për revokimin e vendimit të pezullimit nr. 234, datë 23.04.2019.

9. Në lidhje me themelin e çështjes, Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 00-2022-1832 (275), datë 14.07.2022, ka vendosur: “Mospranimin e rekursit të paraqitur nga palët e paditura, për pikën e tretë të objektit të padisë që lidhet me aktin administrativ, vendimin nr. 10/2017, ndryshimin e vendimeve të gjykatave më të ulëta, si dhe rrëzimin e padisë për kërkimet e tjera.”. Sipas Gjykatës së Lartë, vendimmarrja e gjykatave më të ulëta është rrjedhojë e interpretimit dhe zbatimit të gabuar të ligjit material e procedural. Për sa i përket kërimit të parë të padisë, aktit administrativ, vendimit nr. 2822/2017 të drejtorit të Drejtorisë së ALUIZNI-t, Tirana Jug, kërkuesi nuk ka shteruar më parë ankimin administrativ pranë organit më të lartë dhe, për këtë arsye, nuk mund të jetë objekt i kontrollit gjyqësor. Në lidhje me kërkimin e dytë të padisë, kundërshtimin e aktit administrativ, vendimin nr. 16/2017 të IKMT-së, Gjykata e Lartë ka vlerësuar se kërkuesi e ka paraqitur padinë për këtë akt jashtë afatit 10-ditor të parashikuar nga ligji i posaçëm. Ndërsa, për sa i takon kërkit të tretë, për kundërshtimin e aktit administrativ, vendimin nr. 10/2017 të IKMT-së, sipas Gjykatës së

Lartë, bazuar në nenin 56 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar (*ligji nr.49/2012*), kundër këtij akti nuk mund të bëhet rekurs. Në përfundim, Gjykata e Lartë ka vlerësuar se për sa kohë këto kërkime nuk janë të bazuara, edhe kërkimi i katërt për shpërblimin e dëmit nuk është i bazuar.

10. Në datën 07.02.2023 (sipas shënimit të shërbimit postar), kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, për shfuqizimin e vendimit nr. 00-2022-1832 (275), datë 14.07.2022 të Gjykatës së Lartë.

II

Pretendimet e kërkuesit

11. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se vendimi i kundërshtuar i ka cenuar:

11.1. *Të drejtën e aksesit*, pasi Gjykata e Lartë, në mungesë të palëve ndërgjyqëse, në vendimin e saj është shprehur përtej shkaqeve të paraqitura nga palët e paditura në rekurs. Njoftimet e akteve administrative i janë nënshtruar debatit gjyqësor në gjykatat më të ulëta, ku është vlerësuar se këto akte janë kundërshtuar brenda afateve ligjore për ngritjen e padisë. Asnjëra prej palëve të paditura nuk i ka kundërshtuar këto njoftime në rekurs.

11.2. *Vlerësimin e ligjshëm të provave*, pasi vendimi i datës 15.08.2017 për prishjen e objektit nuk ekziston. Sipas arsyetimit të Gjykatës së Lartë, kërkuesi rezulton të ketë qenë prezent, por ka refuzuar nënshkrimin. Nuk mund të përbëjë provë të marrjes dijeni të vendimit vetëm shënimi i njëanshëm i përfaqësuesve të palës së paditur. Aktet administrative nr. 16/2017 dhe nr. 10/2017, i janë komunikuar kërkuesit në datën 09.10.2019, pra shumë kohë pas prishjes së objektit. Nga kjo datë paditësi, brenda afatit ligjor 10-ditor, ka paraqitur kërkesëpadi në gjykatë, në datën 16.10.2017. Për sa i takon vendimit nr. 2822/2017 të ALUIZNI-t Tirana Jug, ligji i posaçëm ka parashikuar të drejtën e ankimit, por nuk ka parashikuar afatin e paraqitjes së tij. Për këtë arsye, gjen zbatim afati i përgjithshëm i paraqitjes së padisë, 45 ditë nga marrja dijeni e vendimit, i parashikuar nga neni 18, pika 1, i ligjit nr. 49/2012. Gjithashtu, arsyetimi i Gjykatës së Lartë për vendimin nr. 2822/2017 të ALUIZNI-t Tirana Jug, se duhej shteruar me parë ankimi administrativ, është i gabuar. Për këto arsye, edhe vendimmarrja e Gjykatës së Lartë për rrëzimin e kërkesës për shpërblim dëmi është e pabazuar.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkesës

12. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

13. Në rastin në shqyrtim, kërkuuesi legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor, ndaj të cilit ka ngritur pretendime në këtë Gjykatë dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

14. Në lidhje me përmbushjen e kriterit tjetër për legjitimim, që lidhet me *shterimin e mjeteve juridike efektive*, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, individ mund t’i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual, vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ai pretendon se i janë cenuar (*shih vendimet nr. 35, datë 01.11.2021; nr. 33, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Në rastin konkret, vërehet se kërkuuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm dhe pasi ka shteruar mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta. Për rrjedhojë, ai e plotëson edhe këtë kriter.

16. Për sa i përket legjitimitetit *ratione temporis*, sipas nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, ankimi kushtetues individual shqyrtohet nga Gjykata kur kërkesa është paraqitur brenda afatit 4-mujor nga konstatimi i cenimit. Gjykata në jurisprudencën e saj, në rastet e kundërshtimit të vendimeve gjyqësore, ka llogaritur afatin 4-mujor, duke filluar nga data e dhënies së vendimit nga gjykata që ka përfunduar procesin gjyqësor, nëse kërkuuesi nuk

provon në nivel kushtetues se ka marrë dijeni në një datë të ndryshme (*shih vendimet nr. 84, datë 26.12.2017; nr. 80, datë 18.12.2017; nr. 79, datë 14.12.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Duke iu rikthyer rastit konkret, Kolegji vëren se kërkuuesi i është drejtuar Gjykatës në datën 07.02.2023, ndërsa vendimi gjyqësor që kundërshtohet prej tij, është dhënë nga Gjykata e Lartë në datën 14.07.2022, pra pas rreth 7 muajsh. Në këtë kuptim, konstatohet se ankimi kushtetues individual është paraqitur jashtë afatit ligjor. Në lidhje me këtë fakt, kërkuuesi ka pretenduar se “*në mënyrë jo të drejtpërdrejtë*” është vënë në dijeni të këtij vendimi dhe se për këtë vendimmarrje nuk është njoftuar asnjëherë. Ndërkohë, referuar faqes zyrtare të Gjykatës së Lartë, rezulton se në datën 27.06.2022 është publikuar data e seancës së çështjes së kërkuarit e parashikuar për t’u zhvilluar në datën 14.07.2022. Po në datën 14.07.2022, në faqen zyrtare të internetit të Gjykatës së Lartë, është shpallur edhe dispozitivi i vendimit për çështjen e tij. Gjithashtu, rezulton se vendimi i kundërshtuar nga kërkuuesi është publikuar në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë.

18. Ndërkohë, Gjykata, në datën 20.03.2023, i ka kërkuar informacion Gjykatës së Lartë për zbardhjen e vendimit të saj për çështjen e kërkuarit. Në përgjigjen e saj, Gjykata e Lartë e ka informuar Gjykatën se vendimi i kundërshtuar nga kërkuuesi, objekt i këtij gjykimi kushtetues, është bërë i disponueshëm për palët në datën 01.08.2022 dhe është publikuar në faqen e saj zyrtare të internetit në datën 10.09.2022. Referuar edhe këtyre datave, Kolegji vëren se ankimi kushtetues individual nuk e plotëson kriterin *ratione temporis*, pasi është paraqitur jashtë afatit ligjor.

19. Në vështrim të sa më sipër, nisur edhe nga fakti se kërkuuesi ka qenë në dijeni për zhvillimin e gjykimit në Gjykatën e Lartë, i cili ka pasur detyrimin të ndjekë fatin e çështjes së tij, si edhe në kushtet kur ai nuk ka paraqitur asnjë provë bindëse për momentin e marrjes dijeni të vendimit të Gjykatës së Lartë të kundërshtuar në këtë Gjykatë, Kolegji çmon se pretendimi i paraqitur nga ai, se ka marrë dijeni për të në mënyrë jo të drejtpërdrejtë dhe se nuk është njoftuar asnjëherë për këtë vendimmarrje, jo vetëm që nuk është i bazuar, por edhe nuk është i tillë që të vërtetojë paraqitjen e kërkesës brenda afatit ligjor 4-mujor.

20. Për sa më sipër, për sa kohë kërkesa është paraqitur jashtë afatit ligjor dhe kërkuuesi nuk legjitimohet *ratione temporis* për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues, Kolegji çmon se nuk është e nevojshme të vijohet më tej me verifikimin e plotësimit të kriterëve të tjera të pranueshmërisë së kërkesës.

21. Në përfundim, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues individual i paraqitur nga kërkuuesi nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “ç”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.